



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT**  
**KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

Nr 35 Prot.

Vlorë, më 17 . 10 . 2018

**VENDIM**

Nr. 2 \_ Data 10.10.2018 \_

**Për miratim të lejes së ujit për hidroenergji , për shfrytëzim të burimit ujq rrjedha ujore e lumit Fterrë ,Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, për Hec "FTERRA 1" të subjektit "Hydroborsh" me administrator Z.Vangjel Ngjelo.**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligjit nr 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", , Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujq", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujq"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni",

**VENDOSI**

**Miratim të lejes së ujit për hidroenergji , për shfrytëzim të burimit ujq rrjedha ujore e lumit Fterrë ,Bashkia Himarë, Qarku Vlorë ,për Hec "FTERRA 1" të subjektit "Hydroborsh" me administrator Vangjel Ngjelo me këto të dhëna:**

Koordinatat KRGJSH: X 489583; Y 4441669; Z 174

Prurja mesatare : 1.57 m3/sek

Prurja e llogaritur: 1 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.5 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Godina e centralit X 487523 Y 4437912 Z 46

Fuqia e Instaluar e Hec "FTERRA 1 "është 2000kw.

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"**

**Ilir PROFKA**

**KRYETAR I K.B.U "VJOSË"**

**Flamur MAMAJ**